# DËSHMI ARKIVI

**A-462984**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kostot e larta, 8% e shqiptarëve nuk kryejnë ekzaminimet e nevojshme mjeksore - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/kostot-e-larta-8-e-shqiptareve-nuk-kryejne-ekzaminimet-e-nevojshme-mjeksore/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:55:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 12:27:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | e8bff4dc9cf0faf0d09f4cc743a2a74510e261bb9c7c5ef30906161839254bf1 |
| TEKSTI | 6ca8a9a6056d4e0476dc02dfad3a7f2cfdfb67d4c359fe398e71f14c3ea87f5f |
| PAMJA | 27632cd4d93397c4c844d48f2abe8581f09ea0620953211d42aa38deb6674610 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 5d2bc902e95ed2728db563741623a24d75568d24144106ad6ec99bca2c59e22d |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5d2bc902e95ed2728db563741623a24d75568d24144106ad6ec99bca2c59e22d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# Kostot e larta, 8% e shqiptarëve nuk kryejnë ekzaminimet e nevojshme mjeksore

23 Shtator 2026 | 14:27

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

8% e popullsisë shqiptare mbi 16 vjeç nuk ka kryer një ekzaminim të nevojshëm mjeksor përgjatë vitit 2024, si pasojë e kostos së lartë.

Të dhënat e fundit të Eurostat mbi shërbimin shëndetësor, sipas vetëraportimeve të qytetarëve e rendit Shqipërinë të dytën pas Greqisë, ku kostoja pengon më shumë qytetarët të marrin kujdesin shëndetësor që u nevojitet. Në një kohë që mesatarja e Bashkimit Europian për vitin 2025 ishte vetëm 1%.

Pas Greqisë dhe Shqipërisë, diferenca është e madhe. Në vitin 2025, pamundësia për të përballuar financiarisht ekzaminimin prekte 2.5% të popullsisë në Letoni, 2% në Rumani, 1.9% në Francë dhe 1.6% në Itali.

Përvec kostos pacientët shqiptarë kanë listuar dhe një sër arsyesh të tjera që I kanë penalizuar për të realizuar ekzaminime shëndetësore që ju nevojiten.

1.5% deklaruan se nuk kishin marrë ekzaminimin për shkak të listës së pritjes dhe 0.2% për shkak se shërbimi ndodhej shumë larg. Të tria së bashku përbënin 9.8% të popullsisë.

2% e popullsisë mbi 16 vjeç ka deklaruar se nuk e kishte kryer ekzaminimin sepse kishte preferuar të priste për të parë nëse problemi do të përmirësohej vetë. Ndërkohë që mungesa e kohës ishte gjithashtu një pengesë e rëndësishme. Rreth 1.8% e popullsisë deklaroi se nuk kishte pasur kohë për të kryer ekzaminimin,

Edhe pse të rralla por ka raste kur frika nga përgjigjet I lë disa paciente pa ekzaminime.

0.2%, e qyetarëve kanë deklaruar si arsye frikën nga mjeku, spitali, ekzaminimi ose trajtimi, ndërsa 0.1% raportoi se nuk njihte një mjek ose specialist të mirë. Të gjithë këta faktorë kanë bërë që shumë qytetar të mos marrin shërbimin e nevojshëm shëndetësor në kohë.

**Shiko në:**

LAJMI I FUNDIT

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

20:16 Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:11 Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI

20:05 Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve

19:51 Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet

19:37 E ardhmja e Merz në pikëpyetje, gati gjysma e votuesve kërkojnë zgjedhje të reja

TESTIM

## LAJME TE SUGJERUARA

AKTUALITET | EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | VENDI

### Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një...

20:28 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Tatimet vijojnë rimbursimin e tatimit të mbipaguar, rreth 2200 përfitues

Administrata Tatimore po vijon procesin e rimbursimit të tatimit të mbipaguar për individët në kuadër të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin...

18:12 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Dhunoi fizikisht dhe psikologjikisht një vajzë dhe vëllain e saj të mitur, ndalohet nga AMP polici në Klos

Është ndaluar këtë të mërkurë nga AMP një punonjës policie në Klos, pasi akuzohet për veprën penale "Dhunë në familje". Sipas njoftimit të AMP-së, punonjësi...

17:46 | 23/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.